



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si Marrëveshjes së Bashkëpunimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Fondacionit Terre des hommes, Delegacioni në Kosovë të datës 02.12.2016 nr.1-561-65989 , Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS NGA ZYRA LOKALE PËR
KOMUNITETE

Neni 1

Nëpunësi civil, Gradimir Zarkoviq – nga Zyra Lokale për Komunitete caktohet zyrtar përgjegjës për të marrë pjesë në takimet Tryezës për Menaxhimin e Rasteve, sipas Marrëveshjes për Bashkëpunim nr. 1-561-65989 të datës 02.12.2016.

Neni 2

Nëpunësi i cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do ti kryej detyrat konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1-561-65989 të datës 02.12.2016, qëllimi i së cilës është formalizimi i bashkëpunimit në mes të palëve me qëllim të ngritjes së nivelit të mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, duke siguruar bashkëpunim dhe koordinimin ndër-institucional dhe të profesionistëve përgjegjës.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet nëpunësi civil Gradimir Zarkoviq, Qendra për Punë Sociale, Zyra Lokale për Komunitete dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

1Nr. 112 - 3870
Lipjan, më 30.01.2017



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti